



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 151, Datë 29.06.2021

MBI

**MIRATIMIN “UDHËZUESIN PËR TESTIMIN E TREGUT PËR GAZSJELLËSIN
TRANS ADRIATIK”**

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1, gërma “a”; 16, pika 24 dhe nenit 108, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (‘Opinionit Përfundimtar i Përbashkët’) i Kodit të Tarifave të TAP AG dhe të Rregullores së BE 2017/459 për krijimin e një Kodi të Rrjetit mbi Mekanizmat për Alokimin e Kapacitetit për sistemet e transmetimit të gazit (‘Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit’), si dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 29.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorja e Gazit Natyror, mbi miratimin e “Udhëzuesin për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik” dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG më datë 11 qershor 2021.

Duke patur parasysh:

- Direktivën 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Korrikut 2009;
- Direktivën (BE) 2019/692 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 Prillit 2019;
- Rregullorja (BE) 2017/459 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Marsit 2017(CAM NC);
- Rregullorja 2019/942/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Qershorit 2019;
- Vendimit të Komisionit Evropian i 16 Majit 2013, që përmban ‘Përjashtimin e Gazësjellësit Trans Adriatik nga aksesit i palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë të përcaktuara në nenet 9, 32,41(6),41(8),41(10) të Direktivës 2009/73/EC;
- Paragrafi 4.1.7 i Opinionit të Përbashkët, TAP AG duhet rregullisht(të paktën çdo dy vjet) të kryejë një Test të Tregut me qëllim që t’u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitetet shtesë derisa të arrihet mundësia maksimale e zgjerimit të tubacionit;
- Testi i Tregut, i referuar në paragrafin e mëparshëm, duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkarisht nga autoritetet rregullatore të energjisë Shqiptare (ERE), Greke (RAE) dhe Italiane (ARERA)

- Në datën 29 Gusht 2011 TAP AG paraqiti në Ministrinë Italiane të Zhvillimit Ekonomik dhe në datën 31 Gusht 2011 paraqiti tek Autoriteti Rregullator i Energjisë në Greqi (RAE) “Aplikimin e Përjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik” si parashikohet nga Neni 36, i Direktivës së Gazit 2009/73/EC. Në datën 1 Shtator 2011, TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) “Aplikimin e Përjashtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik”, sipas Nenit 22, të Direktivës së Gazit 2003/55/EC.
- Në Qershor 2013 Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Italisë, RAE dhe ERE morrën vendimin për përjashtimin duke miratuar *Opinionin Përfundimtar të Përbashkët*, një dokument i shkruar në mënyrë të përbashkët nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë: “Autoritetet”) dhe e ndryshuan për tu përputhur me Vendimin e Komisionit [C(2013)2949 përfundimtar] datë 16 Maj 2013 dhe morën parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013.
- Në datën 16 Mars 2017, u miratua Rregullorja e re e BE 459/2017 “Për krijimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit tek sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores së (BE) nr 984/2013”. Rregullorja e BE 2017/459 (këtu dhe më poshtë CAM NC) krijon një Kod të Rrjetit ku përcaktohen mekanizmat për alokimin e kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit për kapacitetin ekzistues dhe kapacitetin në rritje.
- Në datën 11 Qershor 2021, në përputhje me Paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG u ka paraqitur Autoriteteve “*Udhëzimet e vitit 2021 për Testimin e Tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik*” (këtu dhe më poshtë: “*Udhëzimet 2021*”).

Gjithashtu duke patur parasysh:

- *Udhëzuesi i propozuar për vitin 2021* përmbledhur më sipër lidhet me parimet e përmendura tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët, tek Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit dhe tek legjislacionet në vend dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme për procesin që parashikohet për ndërtimin e kapacitetit në rritje;
- NC CAM, i aprovuar pas miratimit të Opinionit të Përbashkët, i cili parashikon një procedurë të koordinuar për ofrimin e kapacitetit rritës në pikat e interkoneksionit dhe se kjo procedurë ka filluar me kryerjen e ankandëve të kapaciteteve të parashikuara nga e njëjta NC CAM në të hënën e parë të Korrikut;
- TAP AG duhet tu referohet për zgjerimin e kapacitetit në pikat e interkoneksionit të vendeve ku kalon tubacioni në Legjislacionin e ri Evropian;
- Kompania TAP AG ka filluar një proces koordinimi me OST-fqinje në mënyrë që zgjerimi i TAP të jetë në përputhje me zgjerimin e pikave përkatëse të interkoneksionit dhe të ketë në linjë, për aq sa është e mundur, parashikimet e Opinionit të Përbashkët Përfundimtar dhe parashikimet e CAM NC të ri, me reference të veçantë në kohën në kohën dhe fazat për ofrimin e kapacitetit rritës;
- Letrën e 14 qershorit 2021 që TAP AG dërgoi “*Udhëzimet e Testit të Tregut 2021*” (Shtojca B e kësaj dispozite) në lidhje me ekzaminimin e ofertave të reja të mundëshme të kapacitetit në rritje për Autoritetet për miratim;

- Autoritetet, pas analizimit të “Udhëzimit të Testit të Tregut 2021”, i cili në thelb përfshin të njëjtat parime të ndjekura për Testin e Tregut 2019, së bashku zhvilluam një dokument që përmban vendimin e miratimit dhe arsyet përkatëse (Shtojca A), e këtij vendimi;
- Dokumenti i përbashkët është objekt miratimi edhe nga rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE;
- Procedura e testit të tregut 2021 e propozuar nga TAP AG është në përputhje me parimet e paraqitura në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar dhe me Direktivat e Rregulloret Evropiane për alokimin e kapacitetit ekzistues dhe rritës;
- Nevoja e miratimit të dokumentit të përbashkët që aprovon “Udhëzimet e Testit të Tregut 2021” (Shtojca A);
- Nevojshmërinë që shtojcat e kësaj dispozite (Shtojca A dhe Shtojca B) të mbahen konfidenciale të paktën deri në fillimin e Testit të Tregut 2021 pasi dokumenti i miratuar “*Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2021*” do të publikohet nga TAP AG në faqen e saj në datën e fillimit të Testit të Tregut.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “*Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2021*” dokumenti i paraqitur nga TAP AG më 14 Qershor 2021 (Shtojca B), ashtu si edhe shprehet në vendimin e përbashkët me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE (Shtojca A);
2. Të dërgojë një kopje të këtij vendimi ARERA, RAE , kompanisë TAP AG; si dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji;
3. Të publikojë këtë vendim në faqen e internetit të ERE, www.erealb@ere.gov.al, vendimin pa anekset A dhe B;
4. Të publikojë anekset A dhe B në faqen e internetit të ERE-s pasi TAP AG ka publikuar *Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2021* në faqen e saj të internetit;
5. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.

KRYETARI

Petrit AHMETI